



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 6/2014

**VLERËSIMI I PERFORMANCËS POLICORE GJATË
NDËRRIMIT TË NATËS NË PIKAT E KALIMEVE
KUFITARE**



Aprovuar nga:

Data : ___/___/_____

Fitim Shishani
Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës

SHKURTESAT

| | |
|-------------|---|
| DPP | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë |
| DRPK | Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare |
| DI | Departamenti i Inspektimeve |
| IPK | Inspektorati Policor i Kosovës |
| PK | Policia e Kosovës |
| PKK | Pika e kalimit kufitar |
| PSO | Procedurat Standarde të Operimit |

PËRMBAJTJA

| | |
|---|---------|
| 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE | (4-5) |
| 2. HYRJE | (6-7) |
| 3. PËRMBLEDHJE E TË GJETURAVE | (8-12) |
| 3.1 Vlerësimi i kapaciteteve aktive gjatë turnit të natës dhe respektimi i orarit të punës | |
| 3.2 Vlerësimi i respektimit të standardit për bartjen e uniformës dhe pajisjeve policore | |
| 3.3 Vlerësimi i mirëmbajtjes (pastërtisë) së objekteve policore në stacionet policore kufitare | |
| 3.4 Vlerësimi i nivelit të sigurisë të stacioneve policore kufitare | |
| 4. PËRFUNDIMET | (13-14) |
| 5. REKOMANDIMET | (15-15) |
| 6. PLANI I VEPRIMIT NË PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE . | (16-19) |

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1. Në bazë të nenit 24, paragrafi 2, të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), IPK-ja ndërmarrë një inspektim të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës (PK) lidhur me **“Vlerësimi i performancës policore gjatë ndërrimit të natës në Vendkalimet Kufitare”**. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar kryerjen e detyrave nga zyrtarët policor gjatë ndërrimit të natës në vendkalimet kufitare.

1.2. Inspektimit në këtë fushë i ka paraprirë, hartimi i programit inspektues duke përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjinë e punës. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren më datë 10.10.2014 deri me datë 11.10.2014 dhe zhvillohet në bazë të protokollit zyrtar të inspektimit. Protokolle përmban orarin dhe listën e intervistave që do të kryhen.

1.3. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës në këtë fushë bëhet për të siguruar llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në implementimin e ligjeve të aplikueshme, akteve nënligjore dhe procedurave tjera standarde të veprimit në fuqi si dhe për ngritjen e performancës së zyrtarëve policor në vend kalimet kufitare. Ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur.

1.4. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se ndërrimet apo ekipet policore të inspektuara nuk janë të mbuluara me personelin e nevojshëm siç parashihet me strukturën e organizimit të brendshëm policor. Duhet theksuar se mbikëqyrësit e ndërrimeve apo ekipeve të inspektuara kanë reflektuar në mënyrën e duhur në nxjerrjen e orareve të punës dhe raporteve të punës, përfshirë raportet e punës të ndërrimeve paraprake dhe ato të situatave 24 orësh.

1.5. Sa i përket standardit të bartjes së uniformës dhe pajisjeve tjera shoqëruese, të gjeturat e inspektimit tregojnë se respektimi i rregullit për përdorimin e beherit zyrtar dhe shenjës identifikuese të policit kufitar (shiritit ‘border’) qëndron larg standardit. Megjithatë në numër të vogël gjatë inspektimit janë hasë raste kur zyrtarët policor kishin të veshur këmbishë dhe këpucë jo zyrtare dhe mungesë të kapelës. Gjithashtu të gjeturat e inspektimit tregojnë se një numri të vogël zyrtarësh u kanë munguar shufra dhe spreji, derisa gjendje e papranueshme është paraqitur te pajisja e tyre me bateri dore dhe radio me mbajtës.

1.6. Të gjeturat e inspektimit tregojnë se në dy nga dymbëdhjetë stacionet policore të inspektuara, mbajtja e ambienteve të patra të punës nuk ishte në nivelin e kënaqshëm. Vërehet lëvizje pozitive sa i përket sistemit të ndriçimit me gjithë vërejtjet e vogla që lidhen me funksionimin e plotë të tij. Nevojitet angazhim edhe më i madh i mbikëqyrësve në përmbushjen edhe të kriterëve tjerë, si caktimi i policit të parë të sigurisë dhe mbajtjen e Regjistrit të hyrje- daljeve të personave të pa autorizuar në objekte policore.

1.7. Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport IPK me datë 30.10.2014 ka mbajtur edhe takimin përmbyllës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të gjithë të pranishmit janë pajtuar me këto të gjetura dhe se nuk ka asnjë pikë e cila do të mundë të kontestohet.

1.8. Me datën 07.11.2014 IPK-ja ka pranuar nga Departamenti i Kufirit, Planin e veprimit në realizimin e rekomandimeve, ku është dhënë zotimi i menaxhmentit të PK-së për implementimin e tyre. IPK do të përcjell implementimin e këtyre rekomandimeve konform këtij plani të veprimit.

2. HYRJE

2.1. Bazuar në Ligjin për IPK-në, me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv është zhvilluar inspektim i jashtëzakonshëm për të vlerësuar performancën policore gjatë ndërrimit të natës në stacionet kufitare të PKK-ve.

2.2. Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi ka qenë vlerësimi dhe konstatimi i kryerjes së detyrave policore gjatë ndërrimit të natës lidhur me performancën e PK-së, në vendkalimet kufitare, në ofrimin e lëvizjes së lirë dhe të sigurtë të qytetarëve.

2.3. Objekt i këtij inspektimi ishin stacionet kufitare në PKK-të, në kuadër të DRPK-ve të Divizionit të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes së Kufirit.

2.4. Lidhur me këtë inspektim janë vënë këto objektiva:

- të vlerësohen kapacitetet aktive gjatë turnit të natës dhe respektimi i orarit të punës,
- të vlerësohet respektimi i standardit për bartjen e uniformës dhe pajisjeve policore,
- të vlerësohet niveli i mirëmbajtjes së objekteve në stacionet policore kufitare,
- të vlerësohet niveli i sigurisë së stacioneve policore kufitare.

2.5. Inspektimi në këtë fushë do të kontribuojë në:

- përmirësimin dhe ngritjen e vazhdueshme të performancës së punonjësve në kuadër të stacioneve policore kufitare.
- përmirësimin e shërbimeve duke siguruar shkallë më të lartë të lëvizjes së lirë dhe të sigurtë për qytetarë.
- ngritjen e profesionalizimit, disiplinës dhe përgjegjësisë së zyrtarëve policorë të angazhuar për të qenë efektiv dhe efikas.
- ngritjen e shkallës së sigurisë për pjesëtarët dhe pasurinë policore.

2.6. Metodologjia e përdorur gjatë këtij aktiviteti ka qenë që përmes këtij inspektimi të vlerësohet performanca e PK-së në vendkalimet kufitare, duke:

- intervistuar punonjësit në ndërrimin e natës (menaxherët në detyrë me grada më të larta drejtuese, shefat e ndërrimeve dhe zyrtarët policorë);
- kontrolluar fizikisht stacionet- pikat kufitare policore, duke përfshirë mirëmbajtjen/ pastërtinë në hapësira brenda dhe jashtë objekteve;
- kontrolluar dokumentacionin me të cilin pasqyrohet puna e stacioneve (oraret e ndërrimit, planet operative, raportet e ndërrimeve dhe regjistrat e hyrje- daljeve).

2.7. Programi i punës inspektuese ka paraparë zhvillimin e aktivitetit inspektues në terren në orët e mbrëmjes të datës 10.10.2014, me fillim nga ora 23.00 dhe orët e hershme të mëngjesit të datës 11.10.2014, me fillim nga ora 02.00.

2.8. Inspektimi është përqendruar në këto drejtime apo fusha kryesore:

- Organizimi dhe kapacitetet aktive policore.
- Siguria dhe kushtet higjienike.
- Pajisjet dhe standardet e uniformës.

2.9. Inspektimi është bazuar në këtë kuadër ligjor:

- Ligjin për IPK-në (nr. 03/L-231),
- Udhëzimin Administrativ për Inspektime në PK (nr. 11/2011- MPB),
- Autorizimin zyrtar të lëshuar për kryerjen e inspektimit në PK (10 tetor 2014).

2.10. Puna e inspektorëve është mbështetur në dokumentet vijuese:

- Ligji për Policinë e Kosovës (nr. 04/L-076).
- Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror (nr. 03/L-065)
- Doracakut 'Parimet dhe procedurat e Policisë'.
- Aktet nënligjore policore.
- Procedurat Standarde të Operimit për kategorizimin e pikave kufitare.

3. TË GJETURAT

3.1. Vlerësimi i kapaciteteve aktive gjatë turnit të natës dhe respektimi i orarit të punës

3.1.1. Gjatë procesit të inspektimit të zhvilluar në orët e vonshme të datës 10 tetor 2014 dhe orët e hershme të datës 11 tetor 2014, inspektorët janë pajisur nga mbikëqyrësit e 12 ekipeve apo ndërrimeve, me kopje të orareve të angazhimit të personelit policor dhe të strukturimit organizativ të personelit. Në përputhje me oraret ditore të punës është verifikuar prezenca e vijueshmërisë në punë e punonjësve policorë. Konstatohet se me strukturë organizative, këto ndërrime/ ekipe të stacioneve kufitare duhet të mbulohen me 107 punonjës, përfshirë 15 rreshter dhe 92 polic. Momentalisht këto ndërrime mbulohen me 93 punonjës, përfshirë 13 rreshter dhe 80 polic (*shih tabelën nr. 1*).

3.1.2. Bazuar në oraret e angazhimit të personelit, dokumente këto të nënshkruara nga mbikëqyrësit e ndërrimeve, në kohën kur është zhvilluar inspektimi, në detyra operative kanë qenë të angazhuar gjithsej 60 punonjës nga gjithsej 93 sa numërojnë ndërrimet, përfshirë tetë (8) rreshter dhe 52 polic, kurse 33 punonjës nuk kanë qenë në detyrë. Janë evidentuar tri (3) ndërrime kur në përbërjen e tyre afërsisht $\frac{1}{2}$ e personelit ka qenë jashtë detyre (Qafë Prush, Mutivodë dhe Muqibabë), kurse ndërrimi policor në kuadër të stacionit policor në Merdare ka funksionuar në përbërje të plotë (*shih tabelën nr. 1*).

| Tabela nr. 1. Kapacitetet e burimeve njerëzore të stacioneve policore në PKK (10.10.2014) | | | | | | | | | |
|---|-----------------------|-------|---------------------------------------|-------|-------------------------------|-------|---------------------|-------|--------------------------|
| PKK | Kategoria e stacionit | Ekipi | Të paraparë me strukturë organizative | | Personeli i ndarë për ndërrim | | Personeli në detyrë | | Personel i jashtë detyre |
| | | | Rresht | Polic | Rresht | Polic | Rresht | Polic | |
| Vërmicë | A | B | 2 | 12 | 2 | 11 | 2 | 6 | 5 |
| Hani i Elezit | A | A | 2 | 15 | 1 | 12 | 0 | 8 | 5 |
| Dhe i Bardhë | A | B | 1 | 10 | 1 | 9 | 1 | 6 | 3 |
| Merdare | A | A | 2 | 12 | 2 | 6 | 2 | 6 | 0 |
| Jarinje | A | D | 1 | 7 | 1 | 7 | 0 | 5 | 3 |
| Kullë | A | C | 1 | 6 | 1 | 7 | 0 | 5 | 3 |
| Qafë Morinë | B | B | 1 | 5 | 1 | 5 | 1 | 3 | 2 |
| Gllloboçicë | B | D | 1 | 6 | 1 | 5 | 0 | 4 | 2 |
| Bërnjak | B | D | 1 | 5 | 0 | 4 | 0 | 3 | 1 |
| Qafë Prush | B | B | 1 | 5 | 1 | 5 | 1 | 2 | 3 |
| Mutivodë | B | B | 1 | 4 | 1 | 4 | 0 | 2 | 3 |
| Muqibabë | B | D | 1 | 5 | 1 | 5 | 1 | 2 | 3 |
| Gjithsej | 12 | 12 | 15 | 92 | 13 | 80 | 8 | 52 | 33 |
| % | - | - | 100 | 100 | 86.6 | 86.9 | 61.5 | 63.4 | 35.5 |

3.1.2. Duke qenë të interesuar për performancën policore në hartimin dhe zbatimin e planeve operative policore, mbajtjen e orareve të angazhimit në detyrë të burimeve njerëzore dhe raportimin mbi gjendjen e sigurisë dhe të qarkullimit nëpër PKK, inspektorët janë pajisur me dokumente që dëshmojnë aktivitetet policore planifikuese, operative dhe raportuese. Nuk ka qenë hartuar apo duke u zbatuar nga stacionet policore ndonjë plan i veçantë operacional, përveç atyre të rëndomta që janë përditshmëri dhe përgjegjësi e PKK-ve. Të gjitha stacionet policore kanë prezantuar oraret e angazhimit të personelit në detyrë,

njëjtë siç kanë bërë edhe me raportet e ndërrimeve paraprake dhe raportet 24 orësh ((*shih tabelën nr. 2*).

| Tabela nr. 2. Informata lidhur me nxjerrjen e planeve, orareve te punës dhe raporteve (10.10.2014) | | | | |
|--|-------------------------------|----------------|----------------------|-------------------|
| PKK | Planet operative ¹ | Oraret e punës | Raportet e ndërrimit | Raportet 24 orësh |
| Vërmicë | Jo | Po | Po | Po |
| Hani i Elezit | Jo | Po | Po | Po |
| Dhe i Bardhë | Jo | Po | Po | Po |
| Merdare | Jo | Po | Po | Po |
| Jarinje | Jo | Po | Po | Po |
| Kullë | Jo | Po | Po | Po |
| Qafë Morinë | Jo | Po | Po | Po |
| Gllloboçicë | Jo | Po | Po | Po |
| Bërnjak | Jo | Po | Po | Po |
| Qafë Prush | Jo | Po | Po | Po |
| Mutivodë | Jo | Po | Po | Po |
| Muqibabë | Jo | Po | Po | Po |
| Gjithsej | 0(12) | 12(12) | 12(12) | 12(12) |
| % | 0% | 100% | 100% | 100% |

3.2. Vlerësimi i respektimit të standardit për bartjen e uniformës dhe pajisjeve

3.2.1. Fokus i inspektimit gjatë ndërrimit të natës ka qenë edhe respektimi i standardeve që lidhen me uniformën policore. Parimi P-4.10 përcakton qartë se zyrtarët policorë duhet të tregojnë një pamje personale profesionale, pedante, të rregullt dhe të pastër. Inspektorët kanë kontrolluar 59 zyrtarë në detyrë dhe informatat i kanë prezantuar në formularë standard, të cilët janë nënshkruar edhe nga vet ata. Sa i përket respektimit të standardeve të bartjes së uniformës është konstatuar se: 23 zyrtarë kanë prezantuar bexhin zyrtar, 25 zyrtarë policorë kanë prezantuar se mbajnë në uniformë shiritin me mbishkrim ‘border’, 57 zyrtarë policorë kanë të veshur veshjen e sipërme konform rregullit, 59 zyrtarë policorë bartin pantallonat zyrtar, 55 zyrtarë policorë përdorin këpucët zyrtare dhe 58 zyrtarë policorë bartin kapelën zyrtare. Kuota e përgjithshme mesatare e pajisjes së zyrtarëve policorë me pjesë standarde të uniformës, në nivel të 12 stacioneve të kontrolluara arrin në 78.2% (*shih tabelën nr. 3*).

¹ Në këto plane përfshihen ato planet operative që janë duke u zbatuar nga stacioni në mënyrë individuale apo në bashkëpunim me akterë tjerë e që zbatimi i tyre mund të ndikojë në rritjen e nevojave për kapacitete policore

| PKK | Numri i pajisjeve të identifikuara në raport me numrin e zyrtarëve të inspektuar | | | | | |
|-----------------|--|------------------|------------------------------|-------------------|----------------|---------------|
| | Bexhi zyrtar | Shiriti 'border' | Këmishë zyrtare ² | Pantallona zyrtar | Këpucë zyrtare | Kapelë |
| Vërmicë | 1(8) ³ | 4(8) | 7(8) | 8(8) | 6(8) | 8(8) |
| Hani i Elezit | 2(8) | 4(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) |
| Dhe i Bardhë | 7(7) | 2(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) |
| Merdare | 0(7) | 2(7) | 7(7) | 7(7) | 6(7) | 7(7) |
| Jarinje | 2(5) | 0(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) |
| Kullë | 4(5) | 4(5) | 4(5) | 5(5) | 4(5) | 5(5) |
| Qafë Morinë | 4(4) | 3(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) |
| Gllloboçicë | 0(4) | 3(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 3(4) |
| Bërnjak | 3(3) | 0(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) |
| Qafë Prush | 0(3) | 0(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) |
| Mutivodë | 0(2) | 0(2) | 2(2) | 2(2) | 2(2) | 2(2) |
| Muqibabë | 0(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) |
| Gjithsej | 23(59) | 25(59) | 57(59) | 59(59) | 55(59) | 58(59) |
| % | 38.9 | 42.3 | 96.6 | 100 | 93.2 | 98.3 |

3.2.2. Për kryerjen e detyrave operative, zyrtarët policorë kanë në shfrytëzim pajisje të nevojshme. Inspektorët kanë kontrolluar pajisjet e 59 zyrtarëve dhe po ashtu, informatat i kanë prezantuar në formularë standard të nënshkruar më pas nga zyrtarët policorë. Inspektorët kanë konstatuar se me kartelë identifikuese, rripin zyrtar, armën e zjarrit, këllëfin e armës, karikatorin rezervë dhe prangat me mbajtës janë të pajisur të gjithë zyrtarët e kontrolluar. Nga 59 zyrtar, 58 prej tyre kanë prezantuar shufrat, 55- sprejin, 27- bateritë dhe 17- pajisjen e radios me mbajtës. Kuota e përgjithshme mesatare e pajisjes së zyrtarëve me pajisje, në nivel të 12 stacioneve të kontrolluara arrin në 86.6% (shih tabelën 4).

| PKK | Numri i pajisjeve të identifikuara në raport me numrin e zyrtarëve të inspektuar | | | | | | | | | |
|-----------------|--|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | ID | Rrip | Armë zjarri | Këllëf arme | Karik-atori | Shufr a | Sprej | Bateri dore | Pranga | Radio |
| Vërmicë | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 5(8) | 1(8) | 8(8) | 0(8) |
| Hani i Elezit | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 8(8) | 2(8) | 8(8) | 2(8) |
| Dhe i Bardhë | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 6(7) | 7(7) | 3(7) |
| Merdare | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 7(7) | 4(7) | 7(7) | 0(7) |
| Jarinje | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 0(5) | 5(5) | 1(5) |
| Kullë | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 4(5) | 5(5) | 5(5) | 5(5) | 3(5) |
| Qafë Morinë | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) |
| Gllloboçicë | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 4(4) | 3(4) | 4(4) | 2(4) |
| Bërnjak | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 2(3) | 0(3) | 3(3) | 1(3) |
| Qafë Prush | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 0(3) | 3(3) | 2(3) |
| Mutivodë | 2(2) | 2(2) | 2(2) | 2(2) | 2(2) | 2(2) | 2(2) | 1(2) | 2(2) | 0(2) |
| Muqibabë | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 3(3) | 1(3) | 3(3) | 0(3) |
| Gjithsej | 59(59) | 59(59) | 59(59) | 59(59) | 59(59) | 58(59) | 55(59) | 27(59) | 59(59) | 17(59) |
| % | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 98.3 | 93.2 | 45.7 | 100 | 28.8 |

² Në këtë është përfshirë cila do nga veshjet e sipërme, varësisht nga sezoni i përdorimit të tyre.

³ Numri para kllapës pasqyron gjendjen reale, kurse numri brenda kllapës, numrin e zyrtarëve të kontrolluar.

3.3. Vlerësimi i mirëmbajtjes (pastërtisë) së objekteve policore në stacionet kufitare

3.3.1. Gjatë inspektimit është vërejtur se nga 12 stacione, 5 objekte prej tyre janë objekte të forta ndërtimi kurse 7 stacione zhvillojnë aktivitetet në kontejner apo objekte të lëvizshme. Inspektorët kanë siguruar pamje përmes fotografimit mbi nivelin e pastërtisë brenda tyre dhe në fund të inspektimit kanë vlerësuar përmes notimit gjendjen e pastërtisë. Dhjetë (10) nga 12 stacionet kufitare janë cilësuar ‘mirë’, një (1)- ‘mjaftueshëm’ dhe një tjetër- ‘keq’ (*shih tabelën 5*). Duke marrë parasysh vlerësimin tre shkallësh me nivelin ‘mirë’, ‘mjaftueshëm’ dhe ‘keq’, del se përgjithësisht niveli i pastërtisë është vlerësuar në kuotën 2.75. Sipas informacionit të pranuar, në këto stacione për mirëmbajtjen e pastërtisë ofrohen shërbimet e kontraktuara të operatorëve ekonomikë por edhe të zyrtarëve civilë që janë pjesë e administratës policore.

| Tabela nr. 5. Niveli i mirëmbajtjes (pastërtisë) së stacioneve kufitare (10.10.2014) | | | | |
|--|------------------|---------------------------------|--------------|--------------|
| PKK | Lloji i objektit | Vlerësim i kryer përmes notimit | | |
| | | Mirë | Mjaftueshëm | Keq |
| Vërmicë | Ndërtim | ✓ | - | - |
| Hani i Elezit | Ndërtim | - | - | ✓ |
| Dhe i Bardhë | Kontejner | ✓ | - | - |
| Merdare | Kontejner | ✓ | - | - |
| Jarinje | Kontejner | ✓ | - | - |
| Kullë | Kontejner | ✓ | - | - |
| Qafë Morinë | Ndërtim | ✓ | - | - |
| Glloboçicë | Ndërtim | ✓ | - | - |
| Bërnjak | Kontejner | ✓ | - | - |
| Qafë Prush | Ndërtim | ✓ | - | - |
| Mutivodë | Kontejner | - | ✓ | - |
| Muqibabë | Kontejner | ✓ | - | - |
| Gjithsej | | 10(12) | 1(12) | 1(12) |
| % | | 83.4 | 8.3 | 8.3 |

3.4. Vlerësimi i nivelit të sigurisë të stacioneve policore kufitare

3.4.1. Në përmbushjen e kushteve të sigurisë, inspektorët janë përqendruar kryesisht në pesë kritere bazë, duke konsideruar se paraqesin disa nga elementet prioritar të sigurisë. Nga 12 stacione të inspektuara, dhjetë (10) prej tyre kanë pasur të angazhuar policin e parë apo të sigurisë, tetë (8) stacione policore kanë të pajisur sistemin e vëzhgimit me kamera, të gjitha kanë funksional ndriçimin, dhjetë kanë të rregulluar rrethojat rreth stacioneve dhe 11 prej tyre mbajnë evidencat e hyrjeve daljeve ne objekt për personat e pa autorizuar. Meqë inspektorët ishin të ngarkuar me detyrën edhe të dhënies së vlerësimit mbi nivelin e sigurisë në stacione, dhjetë (10) stacione kufitare janë vlerësuar me nivel të ‘mirë’ të sigurisë dhe dy (2) stacione (Jarinje dhe Mutivodë) me nivel të ‘mjaftueshëm’ të sigurisë (*shih tabelën nr. 6*). Duke marrë parasysh vlerësimin tre shkallësh të nivelit të sigurisë në stacione, me ‘mirë’, ‘mjaftueshëm’ dhe ‘keq’, del se përgjithësisht niveli i sigurisë është vlerësuar në kuotën 2.8. Kurse, kuota e përgjithshme mesatare e nivelit të sigurisë sa i përket përmbushjes së kritereve të sigurisë, në nivel të 12 stacioneve kufitare të kontrolluara arrin afërsisht në 85%

| Tabela nr. 6. Niveli i sigurisë së stacioneve kufitare gjatë ndërrimit të natës (10.10.2014) | | | | | | |
|--|---|--------------------|----------|---------------------|-----------------------------|--------------------------------------|
| PKK | Respektimi i masave të sigurisë në objektet e stacioneve kufitare | | | | | |
| | Polici i parë | Kamerat e sigurisë | Ndriçimi | Rrethoja e objektit | Regjistri i hyrjeve daljeve | Vlerësimi i inspektorit ⁴ |
| Vërmicë | Jo | Po | Po | Po | Po | Mirë |
| Hani i Elezit | Po | Po | Po | Po | Po | Mirë |
| Dhe i Bardhë | Po | Po | Po | Po | po | Mirë |
| Merdare | Po | Po | Po | Po | Po | Mirë |
| Jarinje | Po | Jo | Po | Jo | Jo | Mjaftueshëm |
| Kullë | Po | Po | Po | Jo | Po | Mirë |
| Qafë Morinë | Po | Jo | Po | Po | Po | Mirë |
| Gllboçicë | Po | Po | Po | Po | Po | Mirë |
| Bërnjak | Po | Po | Po | Po | Po | Mirë |
| Qafë Prush | Po | Po | Po | Po | Po | Mirë |
| Mutivodë | Jo | Jo | Po | Po | Po | Mjaftueshëm |
| Muqibabë | Po | Jo | Po | Po | Po | Mirë |
| Gjithsej | 10(12) | 8(12) | 12(12) | 10(12) | 11(12) | - |
| % | 83.3 | 66.6 | 100 | 83.3 | 91.6 | 2.8(3) |

⁴ Vlerësimi i kryer nga inspektorët sipas tre niveleve: i mirë (3), mjaftueshëm (2) dhe i keq (3).

4. PËRFUNDIMET

4.1. Bazuar në ndarjen organizative të datë 28 shtator të vitit 2012, sektori i operativës së stacioneve kufitare të PKK-ve aktivitetin e saj e zhvillon të ndarë në ekipe policore (A, B, C dhe D), të cilat angazhohen në ndërrime 12 orëshe. Inspektorët kanë konstatuar se ndërrimet apo ekipet policore të inspektuara nuk janë të mbuluara me personelin e nevojshëm siç parashihet me strukturën e organizimit të brendshëm, ngase kemi mungesë prej dy (2) rreshterëve dhe dhjetë (10) policëve. Mungesa në numrin e nevojshëm të personelit janë pohuar edhe nga mbikëqyrësit e ndërrimeve në deklaratimet e tyre të zhvilluara në intervistat hyrëse inspektuese. Sa i përket plotësimit të strukturës me gradë 'rreshter policor', vlerësojmë se pozitat udhëheqëse për ndërrimet plotësojnë kuotën deri në 86.6% (ndryshimi minus 2 rreshter), derisa për vendet e punës 'polic' kemi plotësim të kuotës deri në 86.9% (ndryshimi minus 12 polic).

4.2. Në periudhat ku janë zhvilluar vizitat në stacione policore kufitare, ndërrimet nuk janë mbuluar me kapacitet të plotë ngase bazuar në oraret e angazhimit në detyrë kanë qenë të angazhuar 64.5% e kapaciteteve ekzistuese, derisa pjesa tjetër prej 35.5% kanë qenë të angazhuar në trajnime të caktuara dhe në pushime të lejuara nga mbikëqyrësit (pushime vjetore apo pushime tjera). Afërsisht jashtë detyrë ka qenë 1/3 e kapaciteteve ekzistuese të burimeve njerëzore, kurse nuk janë evidentuar mungesa të paarsyeshme në punë.

4.3. Inspektorët kanë konstatuar se dokumentet relevante që lidhen me oraret e punës dhe raportet e punës janë përpiluar në mënyrën e duhur. Gjatë inspektimit nuk ka qenë në zbatim ndonjë plan i veçantë operacional, i cili do të kërkonte angazhim shtesë të kapaciteteve të burimeve njerëzore. Mbikëqyrësit e ndërrimeve kanë prezantuar oraret e angazhimit të personelit, raportet e ndërrimeve paraprake dhe raportet 24 orësh.

4.4. Është konstatuar se standardi i uniformës sa i përket mbajtjes së bexhit dhe shiritit me mbishkrim 'border' respektohet nga më pak se gjysma e zyrtarëve të kontrolluar. Për mospërdorimin e bexhit zyrtar është vlerësuar se rezulton si pasojë e mungesës së tyre, papërshtatshmërisë fizike të bartjes dhe defekteve të paraqitura që pamundësojnë bartjen e tyre në uniformë. Sipas zyrtarëve policorë, mungesa e shiritit me mbishkrim 'border' vjen si pasojë e furnizimit jo të rregullt me këtë shenjë. Rregulli për përdorimin e pantallonave zyrtar respektohet në tërësi nga të gjithë zyrtarët kurse rregulli mbi përdorimin e këmbishës zyrtare, këpucëve zyrtare dhe kapelës zyrtare zbatohet në mbi 90% të rasteve të kontrolluara. Veshja e sipërme në një rast (1) nuk është arsyetuar kurse në një (1) rast tjetër zyrtari policor nuk ka mundur të pajisjet me numër adekuat të përshtatshëm për përmasat e tij trupore. Këpucët zyrtare në dy (2) raste nuk janë përdorur për shkaqe shëndetësore, derisa në dy (2) raste tjera arsyet e mos bartjes nuk janë të bazuara.

4.5. Standardi i pajisjes së zyrtarëve policorë sa i përket ID-së, rripit zyrtar, armës së zjarrit, këllëfit të armës, karikatorit rezervë dhe prangave me mbajtës është i përmbushur plotësisht. Një (1) zyrtarit policor i ka munguar shufra për shkak të humbjes dhe ndaj tij është iniciuar procedurë disiplinore. Katër (4) zyrtarëve policorë u kanë munguar sprejët me arsytimin se u kanë skaduar afatet e përdorimit apo janë përdorur dhe nuk janë zëvendësuar. Kurse gjendje më e rëndë paraqitet tek pajisja e zyrtarëve policorë me bateri dore dhe radio me mbajtës, ku mungesa e tyre është vërejtur tek 32 përkatësisht 42 zyrtarë policorë (afërsisht gjysma e zyrtarëve nuk kanë bateri dore dhe 3/4 e zyrtarëve nuk kanë radio me mbajtës). Mungesa e baterive/ radiove vjen si pasojë e mos furnizimit/ mos zëvendësimit me të reja dhe dëmtimeve eventuale).

4.6. Shumica e stacioneve policore që përbëjnë afërsisht 4/5 apo 83.4% e numrit të përgjithshëm të stacioneve të kontrolluara vlerësohet se i kanë kushtuar kujdesin e duhur mirëmbajtjes higjienike, derisa dy stacione policore (Hani i Elezit dhe Mutivodë) mbetet të bëjnë me tepër në krijimin e ambientit të pastër për punë. Në kohën kur është zhvilluar inspektimi, Stacioni policor i Hanit të Elezit i është nënshtruar një renovimi dhe papastërtia ka qenë e evidente për shkak të punimeve.

4.7. Me gjithë vërejtjet se në disa stacione nuk është ndriçimi adekuat, të gjitha ato kanë të rregulluar këtë sistem. Rreth 4/5 e stacioneve (83.3%) i kushtojnë kujdesin e duhur aktivizimit të policit të sigurisë dhe plotësimin të kriterit të rregullimit të rrethojës. Në mungesë të personelit, ka raste kur rolin e këtyre policëve të sigurisë e kanë marrë ndonjëri nga udhëheqësit e ndërrimeve ose ndonjëri zyrtarë nga personeli në detyrë. Mbi 90% respektojnë kriterin standard të sigurisë për mbajtjen e regjistrave për hyrje dalje të personave të paautorizuar. Rreth 1/3 e stacioneve nuk kanë funksional sistemin e vëzhgimit me kamera.

5. REKOMANDIMET KRYESORE

Në drejtim të përmirësimit dhe ngritjes së vazhdueshme të performancës së personelit policor, IPK-ja nxjerrë për PK-në këto rekomandime kryesore:

1. *IPK-ja i rekomandon Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për Resurse që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për kompletimin e strukturës së stacioneve policore në pikat e kalimeve kufitare me personelin e nevojshëm.*
2. *IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve të ndërrimeve të stacioneve policore kufitare që t'i kushtojnë kujdesin e duhur orareve të angazhimit në detyrë të personelit, në mënyrë që ndërrimet të mbulohen në mënyrën e duhur me personel.*
3. *IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve të ndërrimeve dhe komandantët e stacioneve policore kufitare që të ushtrojnë kontrole të rregullta për të siguruar se vartësit e tyre respektojnë standardet për uniformën dhe pajisjet, kurse zyrtarët policorë të respektojnë standardet e mbajtjes së uniformës dhe bartjes së pajisjeve.*
4. *IPK-ja i rekomandon Departamentit për Shërbime Mbështetëse që të angazhohet në furnizimin (zëvendësimin) me kohë me pajisjet e nevojshme (shufra, sprej, bateri dore, radio me mbajtës, pjesë ndërrimi për bateri dore) dhe pjesë të uniformës për zyrtarët policorë (shirit 'border', bexhë).*
5. *IPK-ja i rekomandon strukturës udhëheqëse të stacioneve kufitare në Han të Elezit dhe Mutivodë që të shtojnë përpjekjet për të krijuar ambient më të pastër sa i përket mirëmbajtjes së higjienës brenda dhe jashtë objekteve të tyre.*
6. *IPK-ja i rekomandon Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse të PK-së të shqyrtojë mundësinë e funksionalizimit të sistemit të mbikëqyrjes përmes kamerave në pikat që nuk kanë të instaluar sistemet e tilla.*
7. *IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të stacioneve policore kufitare që të ngritin masat e sigurisë që bie në kompetencë të tyre , si: aktivizimi i policit të parë/ të sigurisë dhe mbajtja e evidencave në Regjistrin e hyrje- daljeve të personave të paautorizuar në objekte policore.*

6. PLANI I VEPRIMIT PER PERMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE

| Nr | Rekomandimi | Prioriteti | Komentet | Plani i veprimit |
|----|---|---|---|--|
| 1 | IPK-ja i rekomandon Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për Resurse që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për kompletimin e strukturës së stacioneve policore në pikat e kalimeve kufitare me personelin e nevojshëm. | Menaxhimi i resurseve duke plotësuar Strukturën organizative me personel. | Struktura e Departamentit për Kufij, përcakton sistemin e shpërndarjes së personelit, në aspektin kuantitativ dhe kualitativ. Departamentit për Kufij, e deri në plotësimin e këtyre resurseve, ka pritur procesin e promovimit, i cili tani është i përfunduar. | <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesa për personel sipas gradave. Se shpejti Drejtori i Përgjithshëm i Policisë do të bëjë emërimet. • Në vazhdimësi. |
| 2 | IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve të ndërrimeve të stacioneve policore kufitare që t'i kushtojnë kujdesin e duhur orareve të angazhimit në detyrë të personelit, në mënyrë që ndërrimet të mbulohen në mënyrën e duhur me personel | Menaxhimi adekuat i të gjitha resurseve. | Personeli do të angazhohet në pajtim me nevojat operative. Nuk do të ketë zbrastesi në mbulimin e nevojave operative në pikat e Kalimit të Kufirit. Do të lejohet shfrytëzimi i pushimeve të parapara ligjore por pa i dëmtuar nevojat operative. Në raste apo periudha të caktuara (angazhime të ndryshme: trajnime, pushime vjetore, mjekësore, etj.), nëse shkaktohet mungesë e personelit në një ekip të caktuar, ky ekip të përkrahët me personel nga ekipet tjera të cilat kanë personel të mjaftueshëm. | <ul style="list-style-type: none"> • E përfunduar |
| 3 | IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve të ndërrimeve dhe komandantët e stacioneve policore kufitare që të | Standardet e larta profesionale lidhur me pamjen personale të zyrtarëve policorë, | Bartja e uniformës dhe pajisjeve policore është obligative për zyrtarët policor. Veshjet apo pajisjet tjetër shtesë të uniformës të cilat nuk parashihen me | <ul style="list-style-type: none"> • E përfunduar |

| | | | | |
|---|--|--|--|---|
| | <p>ushtrajnë kontrole të rregullta për të siguruar se vartësit e tyre respektojnë standardet për uniformën dhe pajisjet, kurse zyrtarët policorë të respektojnë standardet e mbajtjes së uniformës dhe bartjes së pajisjeve.</p> | <p>mënyrën e veshjes, bartjes dhe mirëmbajtjes së uniformës zyrtarëve. Rregulla standarde-unike për mënyrën e bartjes së uniformës policore dhe pamjen personale të zyrtareve policor.</p> | <p>standarde parimi nuk duhet të bartet. Zyrtari policor, është përgjegjës që uniformën dhe pjesët tjera të dhëna nga shërbimi ti ruajnë dhe mirëmbajë vetë. Humbja apo mungesa e uniformës, pjesëve të saj dhe humbja e pajisjeve që barten me uniformën policore, duhet menjëherë të raportohen te mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i zyrtarit policor.</p> | |
| 4 | <p>IPK-ja i rekomandon Departamentit për Shërbime Mbështetëse të PK-së që të angazhohet në furnizimin (zëvendësimin) me kohë me pajisjet e nevojshme (shufra, sprej, bateri dore, radio me mbajtës, pjesë ndërrimi për bateri dore) dhe pjesë të uniformës për zyrtarët policorë (shirit ‘border’, bexhë).</p> | <p>Standardet e larta profesionale lidhur me pamjen personale të zyrtarëve policorë, mënyrën e veshjes, bartjes dhe mirëmbajtjes së uniformës zyrtarëve. Rregulla standarde-unike për mënyrën e bartjes së uniformës policore dhe pamjen personale të zyrtareve policor.</p> | <p>Zyrtari policor, deri sa është në kryerje të detyrës është i obliguar që ta bartë bexhin-dinstiktin zyrtarë të Policisë. Zyrtarët policor të cilët punojnë në pikat e kalimit kufitar dhe në njësitet patrulluese të vijës së gjelbër të Polici Kufitare, përveç bexhit, janë të obliguar që si shtesë në spaletën e gradave ta bartin edhe shenjën dalluese të Policisë Kufitare. Shenja dalluese është një shirit me ngjyrë të gjelbërt, në të cilin me shkronja ngjyrë arti shkruan “BORDER”.</p> <p>Zyrtaret policor të cilët kanë autorizime policore, deri sa janë në uniformë dhe në kryerje të detyrës duhet ti bartin pajisjet të cilat janë të autorizuara që të bartën.</p> <p>c. Shufrën zyrtare me mbajtësin-fotrollën e tij të tipit ASP;</p> <p>e. Sprejin kimik/ngacmues, i miratuar dhe i dhënë nga Policia, i cili duhet të</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësit për logjistike do të përkujdesen për pajisjen me pajisje të zyrtareve policor, sipas afateve të parapara kohore, dhe zëvendësim e pajisjeve të dëmtuara apo të humbura. • Veprimet do të fillojnë menjëherë dhe do të jene te vazhdimësi. |

| | | | | |
|---|---|--|--|--|
| | | | <p>bartet në fotroll të veçantë. Spreji kimik personale mund të barten vetëm pasi që zyrtari policor ta kryej me sukses trajnimin adekuat dhe të pajiset me certifikatën për përdorimin e mjeteve të tilla kimike;</p> <p>Furnizimi me pajisje është ne proces i vazhdueshëm, ne pajtim me standardet për pajisjet e zyrtareve policor. Çdo pajisje ka kohëzgjatjen e sajë dhe ato duhet të zëvendëson pas skadimit të kohëzgjatjes. Të shfrytëzohen evidencat apo pranim-dorëzimet nga njësitë mbështetëse-logjistike, sa i përket furnizimit.</p> <p>Të respektohen afatet kohore dhe procedurat e raportimit në rastet e humbjes apo dëmtimit të pajisjeve.</p> | |
| 5 | IPK-ja i rekomandon strukturës udhëheqëse të stacioneve policore kufitare në Han të Elezit dhe Mutivodë që të shtojnë përpjekjet për të krijuar ambient më të pastër sa i përket mirëmbajtjes së higjienës brenda dhe jashtë objekteve të tyre. | Përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të punës në Pikat e Kalimit të Kufirit. | Renovimi i objektit të Pikës së Kalimit të Kufirit në Han të Elezit. | <ul style="list-style-type: none"> • E përfunduar |
| 6 | IPK-ja i rekomandon Departamentit për Shërbime | Siguria në zonën e kontrollit kufitare. | Që nga viti 2009, për çdo vit është hapur tender për pajisje të Pikave të | <ul style="list-style-type: none"> • Do të vazhdohet me kërkesë për |

| | | | | |
|---|--|---|--|--|
| | Mbështetëse të PK-së që të shqyrtojë mundësinë e funksionalizimit të sistemit të mbikëqyrjes përmes kamerave në pikat që nuk kanë të instaluar sistemet e tilla. | | Kalimit të Kufirit me kamera për mbikëqyrje të zonës së kontrollit kufitare. Vazhdimisht tenderi për pajisje të Pikave të Kalimit të Kufirit me kamera për mbikëqyrje të zonës së kontrollit kufitare ka dështuar. Tenderi ka dështuar edhe këtë vit. Do të vazhdohet me kërkesë edhe në vitin në vijmë për pajisjen e Pikave të Kalimit të Kufirit me kamera për mbikëqyrje në zonë të kontrollit kufitare. | prokurim/pajisje të Pikave të Kalimit të Kufirit, me kamera për mbikëqyrje të zonës kufitare. <ul style="list-style-type: none"> • Në vazhdimësi. |
| 7 | IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të stacioneve policore kufitare që të ngrisin masat e sigurisë që bie në kompetencë të tyre, si: aktivizimi i policit të parë/ të sigurisë dhe mbajtja e evidencave në Regjistrin e hyrje- daljeve të personave të paautorizuar në objekte policore. | Siguria në zonën e kontrollit kufitare. | Në të gjitha stacionet e pikave të kalimit kufitar ekzistojnë PSO-të për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm. Gjithashtu ekzistojnë regjistrat e evidentimit të personave të paautorizuar që hyjnë në stacionet policore. Evidencat të mbahen nga secili agjenci veç e veç, në libër të veçantë të destinuar për këtë qëllim. Evidencat të mbahen për personat e paautorizuar të cilët vizitojnë objektet apo zyrat për qëllime të ndryshme: kryerje të punëve të ndryshme logjistike, takime të ndryshme, intervistime, etj. | <ul style="list-style-type: none"> • E përfunduar. |